



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 262/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Malbertex” shpk, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-02794-12-31-2018 me objekt “*Blerje uniforma pune per punonjesit*” me fond limit 16,530,900 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Ankimues: “Malbertex” shpk
Rruga “Siri Kodra”, Blloku i magazinave, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Albpetrol sh.a
Lagja “29 Marsi” Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. OE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së OE ankimues.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 31.12.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-02794-12-31-2018 me objekt “*Blerje uniforma*”

pune per punonjesit” me fond limit 16,530,900 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

II.2. Në datën 28.01.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 28.02.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Oltjana Hoxhallari	pa ofertë	I skualifikuar
- Viante Konstruksion	pa ofertë	I skualifikuar
- Denisa Beshaj	pa ofertë	I skualifikuar
- Muca	pa ofertë	I skualifikuar
- Malbertex	15,783,925	I kualifikuar
- W.Center	15,848,860	I kualifikuar
- Paera	16,294,900	I skualifikuar

II.4. Në datën 13.03.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Oltjana Hoxhallari	pa ofertë	I skualifikuar
- Viante Konstruksion	pa ofertë	I skualifikuar
- Denisa Beshaj	pa ofertë	I skualifikuar
- Muca	pa ofertë	I skualifikuar
- Malbertex	15,783,925	I skualifikuar
- W.Center	15,848,860	I kualifikuar
- Paera	16,294,900	I skualifikuar

II.5. Në datën 13.03.2019 operatori ekonomik “Malbretex” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Sipas vendimit nr.12890/8 prot date 11.03.2019 te zyrtarit per shqyrtimin e ankeses. Operatori ekonomik nuk permbush kerkesen e AK lidhur me standartizimin Oeko-Tex standard 100, per produktet Komplet pune xhins (Xhaket+Pantallona) te ofruara nga ky operator ekonomik ne tender, pasi certifikimi Oeko-Tex standard 100 eshte i leshuar per produktet e nje kompanie tjeter dhe jo per produktet e kompanise “Malbertex” shpk*

pjesmarse ne tender, sic kerkohet ne piken 2.3 Kapaciteti teknik germa "b" te dokumentave standarte te tenderit

II.6. Në datën 19.03.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Ne si OE pjesmarrës, kemi dorëzuar ofertën së bashku me dokumentacionin e kërkuar në DST sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara nga AK në këto DT. Në datën 28.02.2019 jemi njoftuar nëpërmjet SPE për kualifikimin tonë ashtu edhe të OE Ë.Center shpk por në datën 13.03.2019 njoftohemi përsëri nga SPE se oferta jonë është refuzuar nga AK me arsyetimin se : Operatori ekonomik nuk permbush kerkesen e AK lidhur me standartizimin Oeko-Tex standard 100, per produktet Komplet pune xhins (Xhaket+Pantallona) te ofruara nga ky operator ekonomik ne tender, pasi certifikimi Oeko-Tex standard 100 eshte i leshuar per produktet e nje kompanie tjeter dhe jo per produktet e kompanise "Malbertex" shpk pjesmarse ne tender, sic kerkohet ne piken 2.3 Kapaciteti teknik germa "b" te dokumentave standarte te tenderit. Ne si kandidat ofertues shprehim kundëstimet tona dhe paraqesim ankesën tonë në lidhje me vlerësimin e dytë të KVO për skualifikimin e ofertës sonë si dhe kualifikimin e OE Ë.Center duke parashtuar argumentimet tona juridiko adminsitraive si vijon:*
- *Ne si OE kemi paraqitur konform DST të gjitha certifikatat , autorizimet dhe msotrat e kërkuara nga ana e AK. Me siguri që KVO duhet ta dijë se për çfarë është ky standart. Stadart 100 nga OEKO Tex është një sistem testimi dhe certifikimi I pavarur në të gjithë botën për produkte të papërpunuara , gjysëm të gatshme dhe të përfunduara të tekstit në të gjitha nivelet e përpunimit si dhe materialet ndihëmëse të përdorura. Shëmbuj të artikujve që mund të certifikohen: fije të papërpunuara dhe të lyer/të përfunduara , pëlhura të thurura dhe të thurura , pajisje të tilla si butona, fasteners zinxhir, temat e qepjes ose etiketat , artikuj të gatshëm të llojeve të ndryshme (veshje të të gjitha llojeve, tekstile, liri krevat, produkte të mëndafshit dhe shumë më tepër.*

Në kuptim të këtij standarti ne kemi paraqitur Certifikatën OEKO-TEX të prodhuesit të lëndës së parë domethënë të pëlurhave të thurura në këtë rast të pëlurhës xhins. Gjithashtu në kuptim të kërkesës së pikës e të kapacitetit teknik ne kemi paraqitur edhe autorizimin e mbajtësit të Certifikatës OEKO TEX Standart 100 për kompaninë tonë Malbertex shpk autorizim të cilin KVO që ka bërë rivlerësimin qëllimisht e ka lënë pa vlerësuar dhe e ka shkëputur nga konteksti i përgjithshëm për ta bërë të pavlefshme ekzistencën e certifikimit të produktit. Seti i plotë i dokumentacionit lidhur me këtë kriter gjendet dhe kuptohet shumë qartë në SPE.Tekstili bazë që duhet për të prodhuar kompletin e punës xhins

(xhaketë+pantallona) është i certifikuar, rrjedhimisht edhe produkti del i certifikuar. Po sjellim në vëmendje të AK se jemi pjesmarrës të rregullt në procedurat e shpallura ga AK Albpetrol sha të paktën në katër vitet e fundit dhe në asnjë nga këto pjesmarrje megjithëse kemi dorëzuar të njëjtin dok nuk jemi skualifikuar të paktën për këtë produkt. Kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.

1. Gjithashtu ne kërkojmë skualifikimin e OE W.Center me argumenat si mëposhtë:

- Ky OE nuk përmbush kriteret e pikës 1 KPPK pika a*
- Nuk përmbush kriteret e pikë 2/b vërtetim që ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike*
- Nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit 2017*
- Nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001;2015*
- Dyshojmë se përmbush kërkesat e AK lidhur me standartizimin OEKO Tex standart 100*
- Nuk përmbush specifikimet teknike*
- Skedat teknike nuk janë në përputhje me specifikimet teknike.*

II.7. Me shkresën nr. 2604/1 prot datë 25.02.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.8. Në datën 28.03.2019 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Sipas vendimit nr.12890/8 prot date 11.03.2019 te zyrtarit per shqyrtimin e ankeses. Operatori ekonomik nuk përmbush kërkesen e AK lidhur me standartizimin Oeko-Tex standard 100, per produktet Komplet pune xhins (Xhaket+Pantallona) te ofruara nga ky operator ekonomik ne tender, pasi certifikimi Oeko-Tex standard 100 eshte i leshuar per produktet e nje kompanie tjeter dhe jo per produktet e

kompanise “Malbertex” shpk pjesmarese ne tender, sic kerkohet ne piken 2.3 Kapaciteti teknik germa “b” te dokumentave standarte te tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3/b,c,e “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Ofertuesit duhet te paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar qe vertetojne se mallrat e meposhtem te ofruar jane ne perputhje me standartet si me poshte:

- **Xhup dimeror**, standarti EN ISO 11611, EN ISO 11612
- **Kominoshe pune**, standarti EN ISO 11611, EN ISO 11612
- **Kepuce pune**, standarti EN ISO 20345 dhe direktiven nr 89/686
- **Cizme pune**, standarti EN ISO 20345 S5 dhe direktiven nr 89/686
- **Kaskete minatori**, standarti EN 397:1995+A1/EN 397:2012+A1:2012
- **Jelek fosforeshent**, standarti SB EN 471
- **Dorashka pune**, standarti EN 388:2003
- **Elektrik dore**, i certifikuar sipas standarteve CE ose ROHS
- **Perparese meshini**, standarti EN ISO 11611:2007 Class 2/A1
- **Dorashka saldatori**, standarti EN12477 Type A
- **Dorashka antikimike**, standarti EN 388-2003 dhe EN 420-2003
- **Syze pune**, standarti EN 166:2001 dhe direktiva nr 89/686
- **Komplet pune xhins (Xhaket+Pantallona), Oeko-Tex standard 100**

(Çertifikatat te jete te perkthyer dhe te noterizuara, nese nuk jane ne gjuhen shqipe).

c) Fotografi apo Katalog teknik nga firma/t prodhuese per artikujt e tenderuar, mbi bazen e te cilave Autoriteti Kontraktor te gjykoje nese mallrat e ofruar plotesojne kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit. (Pjeset specifike ku jepen karakteristikat e mallit qe prokurohet n.q.s nuk jane ne gjuhen shqipe te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Ne fotografi apo katalog te evidentohen qarte mallrat e ofruara per Autoritetin Kontraktor ne kete procedure prokurimi.

e) Ofertuesi ne rast se nuk eshte prodhues, te paraqese Autorizim nga Prodhuesi, ose distributor i autorizuar, i cili merr persiper te furnizojë Ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. (Autorizimi te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Malbertex” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Merketeks Tekstil Autorizim me përmbajtje si vijon: *Nëpërmjet kësaj ne autorizojmë Malbertex shpk të përdori certifikimin tonë OEKO-TEX gjatë pjesmarrjes në prokurime publike në shqipëri me produktet tona . Ky autorizim është i vlefshëm për një vit nga data e lëshimit.*
- Certifikatë lëshuar nga Aitex instituti teknologjik i tekstileve për kompaninë Merketeks Tekstil san.tic.ltd.sti me përmbajtje si vijon: *I është dhënë autorizim sipas standartit Oeko –tex 100 për të përdorur markën Oeko tex në bazë të test raportit 20180K0566 për artikujt e mëposhtëm: Fabrikë leshi e bardhë e lyer bërë nga 100% poliestër dhe poliestër/viskoze (rayon) prodhuar nga materiale të certifikuar sipas standartit 100 nga Oeko tex.*
- Autorizim Prodhuesi lëshuar nga shoqëria Malbertex me përmbajtje si vijon: *Malbertex shpk autorizon Malbertex shpk të paraqesë, të negocjojë dhe të nënshkruajë kontratë me AK Albpetrol sha për tenderin me objekt “Blerje uniforma pune për punonjësit” që zhvillohet më datë 28.01.2019 për mallrat e prodhuar nga ne, kostume xhins dhe përparëse standarte. Asnjë tjetër nuk ka të drejtë të paraqesë ofertë për mallrat e prodhuar nga ne.*
- Katalogë në emër të shoqërisë Malbertex unifoma dhe veshje profesionale për artikujt Kostum Xhins dhe Përparëse Pune.

III.1.3. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sqarohet si vijon: *Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ky operator në SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim të datës 21.06.2018 të lëshuar nga kompania Merketeks tekstil sipas të cilit kompania Merketeks Tekstil autorizon kompaninë Malbertex shpk të përdorë certifikimin e saj OEKO Tex standart 100 me afat një vjeçar për pjesmarrje në prokurimet publike me produktet e kompanisë Merketeks Tekstil. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se kompania Malbertex shpk për zërin kompletin e punës xhins (Xhaketë +pantallona) ka ofruar produktin e prodhuar nga vetë kjo kompani dhe për këtë artikull nuk ka paraqitur certifikimin Oeko Tex Standart 100. Operatori ekonomik Malbertex shpk ka paraqitur certifikimin e kompanisë Merketeks Tekstil për produktin komplet pune xhins (xhaketë+pantallona) dhe jo certifikim për produktet e saj dhe për të cilat kjo kompani ka dhënë ofertë në tender. Akoma më tej ky certifikim nuk mund të transferohet tek subjektet e tjera pasi këto certifikime leshohen, inspektohen dhe auditohen nga organe të licesuar për subjekte të specializuara në fushën e prodhimit të tekstileve dhe janë të lëshuara për produktin që testohet. Në cerifikatën e lëshuar nga kompania Merketeks Tekstil është i*

evidentuar fakti se kjo certifikatë është lëshuar vetëm për produktet e kësaj kompanie të testuara fillimisht. Pra operatori ekonomik nuk mund të përdorë një certifikatë e cila nuk është lëshuar për produktet e prodhuara prej tij.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

STANDARD 100 nga OEKO-TEX® është një sistem testimi dhe çertifikimi i pavarur në të gjithë botën për produktet tekstile të papërpunuara, gjysëm të gatshme dhe të përfunduara në të gjitha nivelet e përpunimit, si dhe materialet ndihmëse të përdorura. Shembuj të artikujve që mund të certifikohen: fije të papërpunuara dhe të lyer / të përfunduara, pëlhura të thurura dhe të thurura, pajisje, të tilla si butona, fasteners zinxhir, temat e qepjes ose etiketat, artikuj të gatshëm të llojeve të ndryshme (veshje të të gjitha llojeve, tekstile, liri krevat, produkte të mëndafshit dhe shumë më tepër.

III.1.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit për artikullin Komplet pune xhins (Xhaket+Pantallona), është kërkuar të paraqitet certifikata Oeko-Tex standard 100 të lëshuara nga organe të pavaruara. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesmarrës të paraqesin katalogë teknikë për mallrat e ofruar, si dhe autorizim prodhuesi në rastin kur nuk janë vetë prodhues të mallrave objekt prokurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Malbertex” shpk rezulton se në përmbushje të kriterëve sa më sipër është dorëzuar dokumenti autorizim prodhuesi si dhe katalogë teknikë për artikullin komplet xhins (xhaketë +pantallona) në emër të shoqërisë pjesmarrse në tender Malbertex shpk duke u shfaqur kështu në cilësinë e prodhuesit për këtë artikull. Ndërsa sa i takon kërkesës së autoritetit kontraktor lidhur me certifikatën Oeko Tex rezulton se ankimuesi ka dorëzuar një autorizim lëshuar nga kompania Marketeks Tekstil në të cilin rezulton se është autorizuar shoqëria Malbertex shpk të përdori certifikimin e tij OEKO-TEX gjatë pjesmarrjes në prokurime publike në shqipëri me produktet e tyre pa specifikuar në anjë moment llojin e produkteve që kjo kompani autorizon. Gjithashtu është dorëzuar edhe certifikata lëshuar nga Aitex instituti teknologjik i tekstileve për kompaninë Merketeks Tekstil san.tic.ltd.sti me përmbajtje si vijon: *I është dhënë autorizim sipas standartit Oeko –tex 100 për të përdorur markën Oeko tex në bazë të test raportit 20180K0566 për artikujt e mëposhtëm: Fabrikë leshi e bardhë e lyer bërë nga 100% poliestër dhe poliestër/viskozë (rayon) prodhuar nga materiale të certifikuar sipas standartit 100 nga Oeko tex.*

Referuar sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik Malbertex shpk nuk ka paraqitur certifikatën OEKO Tex në emër të tij por certifikatën e kompanisë Merketeks Tekstil për të cilën pretendon se është autorizuar prej saj të përdori certifikimin e saj OEKO tex për produktet e saj. KPP gjykon se pretendimi i autoritetit kontraktor se në rastin konkret se nuk është paraqitur certifikata Oeko-Tex e kompanisë Malbertex shpk e cila me dokumentacionin tjetër të paraqitur shfaqet në cilësinë e prodhuesit të artikullit komplet xhins xhaketë +pantallona rezulton i drejtë. Autorizimi i lëshuar nga kompania Merketeks Tekstil për shoqërinë Malbertex si dhe Certifikata Oeko Tex e kësaj kompanie nuk mund të jenë dokumentacin i vlefshëm për përmbushjen e kriterit kualifikues pasi nuk provohet lidhja mes kompanive në kushtet kur ka vetëm një dokument që autorizon kompaninë Malbertex të përdori certifikimin e Merketeks Tekstil për produktet e saj dhe nuk ka asnjë dokument tjetër i cili të provojë marrëdhënien e bashkëpunimit mes tyre. KPP gjykon se operatori ekonomik pjesmarrës në tender nuk mund të konkurojë me kapacitete të një kompanie tjetër e cila nuk shfaqet në rastin konkret në cilësinë e prodhuesit të artikullit komplet xhins. Sa më sipër, KPP gjykon se plotësimi i kërkesave për kualifikim në një procedurë prokurimi shtrihet vetëm ndaj operatorëve pjesëmarrës dhe në asnjë rast, operatorët nuk mund të përmbushin kapacitetet teknike me anë të dokumentacionit të subjekteve të tjerë juridikë. Dorëzimi i dokumentacionit të një subjekti tjetër i cili nuk është pjesmarrës në procedurën e prokurimit dhe as nuk shfaqet në cilësinë e njërit prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve dhe as prodhues i mallrave objekt prokurimi nuk mund të konsiderohet i vlefshëm duke u paraqitur si dokumentacion i vetë pjesmarësit.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, nuk mund të konsiderohet i plotë dhe i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik W.Center, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të ankimuesit se: Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Normativa e mësipërme rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë në KPP, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje KPP. Procedura përpara KPP ka natyrën e procedurave të nxitura (lat.-*jurisdicion voluntari*) pasi KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave (*ex officio*). Si rregull, investimi i KPP është i bazuar (faktikisht i

kufizuar) nga kërkesat apo ankimet e sjella pranë saj vetëm nga *subjekte të legjitimuar*. Formula ligjore e parashikuar nga Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) përcakton në mënyrë definitive *elementët* e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*. Në kuptim të nenit 63, pika 7, Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm (e jo thjesht në mënyrë imagjinare) të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim nga K.P.P.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Malbertex” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-02794-12-31-2018 me objekt “*Blerje uniforma pune per punonjesit*” me fond limit 16,530,900 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 553 Protokolli; Datë 28.03.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha